



## VENDIM

Nr. 171, datë 7.11.2019

**MBI KËRKESËN E KONCESIONARIT  
“WONDER” SHPK, PËR  
TRANSFERIMIN E PLOTË TË  
LICENCËS SË SHOQËRISË  
KONCENSIONARE “ENERGO-SAS”  
SHPK, NR. 41, SERIA NPM06K, DHËNË  
ME VENDIMIN E BORDIT TË  
KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 83,  
DATË 27.11.2006, PËR NJË AFAT 30-  
VJEÇAR, PËR VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA HEC “SASAJ”, TE  
SHOQËRIA “HYDROPOWER-SAS” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “c” dhe 44 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “c”, nenit 5, pika 1, germa “c”, nenit 10, pika 1, si dhe nenit 17, pika 1, pikat 2, 4 dhe 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 101/4 prot., datë 31.10.2019 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 275 prot., datë 16.9.2019, e protokolluar në ERE me nr. 562 prot., datë 16.9.2019, shoqëria “Wonder” sh.p.k., me cilësinë e koncesionarit, ka paraqitur kërkesën për transferimin e licencës për ndërtimin, instalimin, dhe shfrytëzimin e Hec-it “Sasaj”, nga shoqëria “Energo-SAS” sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë koncesionare, te shoqëria “Hidropower-SAS” sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë koncesionare të krijuar së fundmi nga koncesionari “Wonder” sh.p.k.

- Shoqëria “Energo-SAS” sh.p.k është mbajtëse e licencës nr. 41, seria NPM06K, e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 27.11.2006, për prodhimin e energjisë elektrike nga



HEC-i “Sasaj”, modifikuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 6, datë 16.1.2012, për rritjen e kapacitetit të instaluar në HEC-in “Sasaj” nga 7 mw, në 8.6 mw.

- Shoqëria “Wonder” sh.p.k., me shkresën nr. 275 prot., datë 16.9.2019, ka depozituar në ERE me dokumentacionin e aplikimit, vendimin nr. 8, datë 30.8.2019, të marrë nga asambleja e koncesionarit “Wonder” sh.p.k, ku është vlerësuar veprimtaria e shoqërisë koncesionare, lidhur me mirëmbajtjen, investimin dhe shfrytëzimin e HEC-it “Sasaj”, objekt-marrëveshjes, si dhe analizimi i situatës ligjore të shoqërisë koncesionare “Energo-SAS” sh.p.k.

- Referuar pretendimeve të shoqërisë “Wonder” sh.p.k., rezulton se:

-Shoqëria “Energo-SAS sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 91/18-1 prot., datë 13.2.2019, ka dhënë informacion për vitin 2018, në lidhje me sasinë e prodhuar të energjisë elektrike nga HEC-i “Sasaj” 27’32’180 kWh;

- Ka informuar se është rritur cilësia, duke mbajtur parametrat e daljes së energjisë elektrike nga HEC-i, në parametra optimalë të tensionit dhe energjisë reaktive;

- Gjithashtu nga rakordimet, referuar monitorimeve të kryera nga ana e grupit të punës së ERE-s, ngritur me urdhrin nr. 47, date 25.9.2017 dhe urdhrin nr. 52, datë 4.9.2018, është bërë monitorimi teknik në objekt edhe për këtë shoqëri, nga i cili është konstatuar se: HEC-i “Sasaj”, është lidhur në linjën 35 kV, me kapacitet 8.6 mw e cila përkon me kapacitetin e licencuar nga ERE. Ky HEC është gjetur përgjithësisht në përputhje me rregullat e operimit, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

- Duke krahasuar të dhënat nga dokumentacioni i paraqitur në ERE, si nga aplikuesi “Wonder” sh.p.k. dhe nga shoqëria “Energo-SAS” sh.p.k., si dhe të dhënat e nxjerra nga ekstrakti i QKB-së, rezulton se:

- Së pari: shoqëria “Wonder” sh.p.k. nuk është aksionare e vetme e shoqërisë “Energo-SAS” sh.p.k. dhe për rrjedhojë nuk ka tagër dhe nuk mund të marrë asnjë vendim e vetme në lidhje me ndryshimet e kërkuara;

- Së dyti: nga ana e shoqërisë “Energo-SAS” sh.p.k., rezulton se nuk është kryer raportimi në ERE i shitjes së kuotave të kapitalit (siç rezulton nga analiza e ekstraktit të QKB-së). Referuar

licencës me nr. 41, seria NPM06K, e cila në nenin 4 të saj parashikon “Detyrimet e të licencuarit”, pika 4.6, germa “F”: “i licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për ndryshimin e strukturës së asetëve mbi 10%”. Detyrimi sa më sipër, nuk është përmbushur nga i licencuari.

- Sa më sipër, nuk përbën shkak për aplikimin e penaltiteve për të licencuarin.

- Sa analizuar nga dosja e aplikimit për licencim, e paraqitur në ERE nga shoqëria “Energo-SAS” sh.p.k., rezulton se, në marrëveshjen e koncesionit të formës “BOO”, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe e Energjitikës, Ministrisë Bujqësisë dhe Ushqimit, në cilësinë e organit shtetëror të autorizuar dhe shoqërisë “Wonder” sh.a. për ndërtimin e hidrocentralit “Sasaj”, në nenin 4 “Detyrimet e koncesionarit”, nuk rezulton të jetë parashikuar detyrimi për të njoftuar autoritetin kontraktor apo për të kërkuar miratimin e këtij të fundit për shitjen e kuotave/aksioneve.

- Referuar nenit 17, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016: Kërkesa për transferimin e licencës bëhet nga i licencuari në ERE dhe/ose me iniciativën e kësaj të fundit, mund të transferojë plotësisht dhe pjesërisht licencën e një të licencuari në përputhje me ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Duke marrë parasysh parashikimin se: “...Kërkesa për transferimin e licencës bëhet nga i licencuari në ERE...”, vlen të theksojmë se nga analizimi i kërkesës së shoqërisë “WONDER” sh.a., rezulton se kjo e fundit nuk është shoqëri e licencuar nga ERE-ja dhe si e tillë nuk legjitimohet për të vijuar më tej me pranimin e kërkesës së saj.

- Po ashtu edhe sa i përket parashikimit për fillimin e procedurës së shqyrtimit me iniciativën e ERE-s, nuk rezulton të këtë prova të mjaftueshme që i licencuari të ketë shkelur kushte të licencës, të tilla që në kuptim të legjislacionit në fuqi, të legjitimojnë një iniciativë ligjore për fillimin e procedurës së heqjes apo transferimit të licencës me iniciativë të ERE-s.

- ERE mund të fillojë procedurën me iniciativën e saj, pasi të jetë hetuar e dokumentuar ekzistenca e rrethanave apo shkaqeve që mund të çojnë bordin e ERE-s në një rishikim të vendimit të ERE nr. 83,



datë 27.11.2006, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Sasaj”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë koncesionare “ENERGO-SAS” sh.p.k., me nr. 41, seria NPM06K, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 27.11.2006, për një afat 30-vjeçar, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Sasaj”, të shoqëria “Hydropower-Sas” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.